

UNIVERSITETI I PRISHTINËS “HASAN1 PRISHTINA”

FAKULTETI JURIDIK

Studime Master – Kontrata dhe e drejta komerciale

Kandidatja: Arnitë Mazreku

Mentori: Prof.Ass.Dr.Rrustem Qehaja

Tema: Shpërblimi i dëmit nga mjetet motorike të pasiguara

ABSTRAKT

Shpërblimi i dëmit të shkaktura nga mjetet motorike të pasigurara është e rregullar sipas dispozitave të Ligjit Për Sigurimin e Detyrueshëm nga Autopërgjegjësia. Shpërblimi i dëmit i cili shkaktohet nga mjetet motorike të pasiguruara arrihet të realizohet përmes Byrosë Kosovare të Sigurimeve me anë të organit të saj Fondit të Kompensimit.

Pasojat të cilat po i shkakton numri i madh i mjeteve motorike të pasiguruara janë të mëdha duke ndikuar edhe për antarësim të vendit tonë në organizatën e kartonit të gjelbër si dhe me pasoja edhe për Byron Kosovare të Sigurimit, numri i lartë i aksidenteve të shkatuara nga mjetet motorikë të pasigurar po e dëmton Industrinë e Sigurimeve duke u bërë barrë financiare për Byronë Kosovare të Sigurimit.

Në këtë punim analizohet edhe rregullorja të cilën ka nxjerrur Banka Qendrore e Republikës së Kosovës e quajtur Bonus-Malus, e cila do të ketë ndikimin edhe në uljen e numrit të veturave të pasiguruara. Gjithashtu trajtohet edhe vendosja e stikerave që po aplikohet në momentin kur bëhet sigurimi i automjeteve për të identifikuar më lehtë automjetet të cilat janë të sigurara dhe automatikisht ato automjetet të cilat nuk kanë të vendosur stikerin në automjet do të verifikohen që në shikim të parë që nuk janë të siguruara.

Në këtë punim si qështje me rëndësi e diskutimit është edhe përgjegjësia për dëmin e shkaktuar nga mjetet motorike në lëvizje duke trajtuar veq e veq llojet, bazat dhe kushtete e përgjegjësisë.

Në këtë temë paraqitet dhe përkufizimi i dëmit dhe llojet e dëmit.

Gjatë punimit në fjalë është analizuar dhe krahasuar legjislacioni i vendit tonë me Republikën e Shqipërisë dhe Republikën e Maqedonise, përmes analizimit të dispozitave ligjore vijm në konkluzion për të përbashkëtata dhe dallimet tek rastet e aksidenteve të shkaktuara nga mjetet motorike me regjistrim të huaj dhe trajtimi përmes kartonit të gjelbërt të këtyre rasteve.

Fjalët kyçe: mjet motorik, i pasiguruara, dëmi, përgjegjësi, kompensim.